

VENDIM
Nr.828, datë 3.12.2014

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NGA/NË DETYRË TË KRYETARIT DHE DISA
ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19/2, pika 2, dhe 19/5, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lirimin nga detyra, për shkak të dorëheqjes, të kryetarit dhe disa anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

- z. Denar Biba kryetar;
- z. Muharrem Çakaj anëtar;
- z. Hektor Muçaj anëtar;

2. Z. Gentian Këri emërohet kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Z. Leonard Gremshi emërohet anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama